

VENDIM
Nr.242, datë 22.3.2020

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.203, DATË 26.2.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT QË PËRDOREN PËR LIDHJEN E KONTRATAVE QË
DIKTOHEN NGA INTERESA THELBËSORË TË SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 79 e vijues të Kodit Civil , të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar, të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, dhe të ligjit nr.10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet kreu VIII, me këtë përmbajtje:

“VIII DISPOZITA KALIMTARE PËR PROCEDURAT QË LIDHEN ME EPIDEMINË E SHKAKTUAR NGA INFEKSIONI COVID-19

1. “Autoritetet kontraktore”, të referuara në shkronjën “a”, të kreut III, të këtij vendimi, janë Kryeministria, të gjitha ministritë dhe institucionet e varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të deleguara me urdhër të ministrit përkatës.

2. Për procedurën e drejtpërdrejtë, të përcaktuar në nënndarjen IV.1, të kreut IV, të këtij vendimi, nuk zbatohen dispozitat e parashikuara për procedurën e ankimit.

3. Komisioni i vlerësimit, i përcaktuar në pikën 2, të kreut V, të këtij vendimi, kryesohet nga një nëpunës i nivelit drejtues të lartë të autoritetit kontraktor dhe ka në përbërje të tij nëpunës me arsim të lartë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama